



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 7308

Nr. koleksioni: 2330

Tirane më 31/08/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053950242530284



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Ne Tirane, sot me date 31 / 8 / 2021 (dy mije e njezet e nje), para meje Julian Zhelegu, Noter i Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne adresen Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, u paraqiten:

Shitësi: **Nada Doda**, shtetase shqiptare, e bija e Hiqmetit dhe Natashës, lindur me 24.3.1990 ne Vlore dhe banuese ne Tirane, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 033505969 dhe nr. personal J05324093F, madhore e me zotësi te plote juridike për te vepruar;

dhe

Blerësi: **Amiada Malasi**, shtetase shqiptare, e bija e Luanit dhe Lidës, lindur me 30.4.1991 ne Kuçovë dhe banuese ne Tirane, mbajtëse e pasaportës me nr. BG3304155 dhe nr. personal J15430088D, madhore e me zotësi te plote juridike për te vepruar;

MEQENËSE:

- A. Znj. Nada Doda është ortak i vetëm i shoqërisë tregtare "DAREINVESTMENT" shpk, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L81613005G, me seli ne adresën: Rruga "Mantho Nakuçi", Ndërtesa Nr. 29, Hyrja Nr. 2, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tirane, (me poshtë referuar "**Shoqëria**"), dhe zotëron te gjithë kapitalin themeltar te Shoqërisë, konkretisht nje (1) kuote qe përfaqëson 100% te kapitalit prej 10.000 (dhjetë mije) lekësh te Shoqërisë.
- B. Shitësi dëshiron t' i shesë Blerësit dhe ky i fundit dëshiron te blejë nga Shitësi te gjithë kuotat e kapitalit te Shoqërisë, ne mënyrë qe Blerësi te behet ortak i vetëm zotërues i 100% (njëqind përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Asamblesë se Ortakeve te Shoqërisë, Palët dëshirojnë te lidhin këtë Kontrate.

NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i transferon dhe kalon ne pronësinë e vetme ligjore te Blerësit te gjithë kuotat e kapitalit te Shoqërisë dhe Blerësi blen kuotat, duke u bere kështu ortak i vetëm i Shoqërisë, kundrejt çmimit te shitjes dhe sipas kushteve e afateve te përcaktuara këtu.
2. Çmimi i shitjes se kuotave te kapitalit është i njëjtë me vlerën nominale te tyre ne shumen prej LEK 10.000 (dhjetë mije leke) dhe Palët vërtetojnë se pagesa e çmimit te mësipërm te shitjes është kryer tërësisht nga Blerësi ne favor te Shitësit me lidhjen e kësaj Kontrate dhe kjo



- Kontrate shërben edhe si një dëftesë për vërtetimin e pagimit të shumës. Palët e vërtetojnë shlyerjen e çmimit dhe nuk kanë asnjë pretendim tjetër të asnjë lloji.
3. Me lidhjen e kësaj Kontrate Blerësi behet ortak i vetëm zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë prej 10.000 leke dhe njëkohësisht Blerësit i lind e drejta e regjistrimit të pronësisë së vet mbi kuotën në librin e ortakeve dhe në regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit.
 4. Shitësi deklaron dhe garanton se pjesët e kapitalit të transferuara nëpërmjet kësaj Kontrate, janë në pronësinë e vetme e të plote ligjore të Shitësit dhe janë të lira nga barra, të drejta të tjera reale apo pengje apo të drejta të çfarëdolloji të palëve të treta mbi to.
 5. Shitësi shprehimisht heq dorë nga e drejta për pagimin e dividendëve për periudhën përpara transferimit të kuotave sipas kësaj Kontrate.
 1. Blerësi deklaron dhe garanton se e njeh gjendjen e Shoqërisë dhe se ka verifikuar regjistrimet e saj kontabël si dhe të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë në tërësi dhe për këtë nuk ka dhe shprehimisht heq dorë nga çdo rezerve, pretendim apo padi kundër Shitësit, duke garantuar se do ta mbaje Shitësin të padëmtuar nga çfarëdo pretendimi i tillë. Blerësi shprehimisht një veçanërisht të gjithë detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve dhe nuk ka as nuk do të ketë në të ardhmen ndonjë pretendim nga shitësi për këto detyrime .
 2. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotave objekt të kësaj Kontrate në librin e ortakeve si dhe në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas kërkesave të ligjit.

Kontrata u redaktua nga unë noteri sipas kërkesës së palëve në gjuhën shqipe dhe në 4 kopje origjinale, dhe pasi iu lexua dhe iu shpjegua palëve nga unë noteri me zë të lartë dhe të qartë u kuptua dhe u pranua prej palëve, u nënshkrua rregullisht dhe pa vërejtje prej palëve në praninë time dhe unë, noteri, e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë efektet e tij.

SHITESI
Nada Doda

Nada Doda

BLERESI
Amiada Malasi

AMIADA MALASI

NOTERI
Julian Zhelegu



VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
“DAREINVESTMENT” shpk.

Sot, me date 31 gusht 2021, Ortaku i Vetem i Shoqerise “DAREINVESTMENT” shpk. (ne vijim “Shoqeria”), një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L81613005G, me seli ne adresën: Rruga "Mantho Nakuçi", Ndërtesa Nr. 29, Hyrja Nr. 2, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tirane, ne perputhje me Statutin dhe Ligjin 9901/2008, te ndryshuar,

VENDOSI:

1. Te pranoje doreheqjen e administratores znj. Nada Doda dhe te emeroje ne detyren e administratorit me mandat 5 (pese) vjecar emerimi znj. Amiada Malasi, e ditelindjes 30.4.1991, lindur ne Kuçovë.
2. Te miratoje ndryshimin e adreses se selise se Shoqerise nga Rruga "Mantho Nakuçi", Ndërtesa Nr. 29, Hyrja Nr. 2, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tirane, e cila mbyllet, ne adresën e re Rr. Vaso Pasha, Hyrja 1, Ap. 10, ZK 8270, pasuria nr. 5/325+1-10, Njesia Bashkiake nr. 5, Tirane.
3. Te miratoje shitjen e 100% (njqind perqind) te kuotave te kapitalit nga ortakut i vetem Nada Doda te znj. Amiada Malasi. Te autorizojte lidhjen e kontrates / marreveshjes perkatese pa kufizim kohor dhe sipas kushteve e afateve te caktuara nga palet.

Ky Vendim u miratua dhe u nenshkrua rregullisht nga ortakut i vetem i Shoqerise si me poshte vijon:

ORTAKU I VETEM

Nada Doda

Nada Doda

